



Në bazë të nenit 113 paragrafi 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fletorja zyrtare e MZ", nr 02/18, 034/19, 038/20 dhe 050/22) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurës për plotësimin e vendit të punës numër 01-031/22-6762 të datës 21.06.2022, Sekretariati për vetëqeverisje lokale- Zyra për burime njerëzore, **s h p a l l**

## KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

### 1. Menaxher/e i/e komunës së Tuzit

- Ekzekutues: 1, në kohëzgjatje të caktuar, person i cili kryen punët e kuadrit të lartë drejtues emërohet në periudhë prej 5 (pesë) vitesh;
- niveli i VIII i kualifikimit të arsimit;
- Fakulteti ekonomik, fakulteti i menaxhimit ose fakulteti i shkencave shoqërore;
- provimin profesional për punë në organet shtetërore;
- Më së paku pesë vite përvoj pune në fushën e planifikimit dhe zbatimit të politikave zhvillimore;
- Njohja e punës në kompjuter;
- Njohja e gjuhës shqipe dhe angleze.

### Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes në vend pune të lirë (Formulari i paraqitjes në vend pune të lirë kandidatët mund të nxjerrin në sajtin e komunës së Tuzit, [www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me) ose drejtpërdrejtë në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- kopja e letërnjoftimit biometrik e vërtetuar,
- diploma ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit e vërtetuar,
- vërtetimin se nuk është denuar për vepër penale që e bën të papërshtatshëm për të punuar në organet shtetërore, e siguron organi sipas detyrës zyrtare,
- dëshmi (vërtetim) mbi përvojën e punës së kërkuar e vërtetuar,
- vërtetim mbi provimin profesional të dhënë për punë në organet shtetërore e vërtetuar.

Kandidatët janë të detyruar që Zyrës për burime njerëzore (në tekstin e mëtejshëm: Zyrja) të dorëzojnë me formularin e paraqitjes origjinal dokumentacionin ose kopjet e vërtetuara të dokumentacionit.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh marrëdhënie pune personi i cili është shfrytëzues i të drejtës në pension, në përputhje me ligj.

Zyrtari shtetëror, gjegjësisht nëpunësi i cili ka realizuar të drejtë në dëmshpërblim nuk mund të lidh marrëdhënie pune në organin shtetëror ose personin juridik, në periudhë prej një viti nga dita e pagesës së dëmshpërblimit. Kufizimi nuk zbatohet për person që kthen të gjithë shumën e dëmshpërblimit të paguar.

Verifikimi i kompetencave, njohurive dhe aftësive të kandidatëve për plotësimin e vendit të punës nga kategoria e kuadrit të lartë drejtues do të zbatohet në përputhje me nenin 121 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fletorja zyrtare e MZ", nr.02/18, 034/19, 038/20 dhe 050/22).

Verifikimi i kompetencave, njohurive dhe aftësive të kandidatëve nënkupton hartimin e punimit me shkrim, i cili përfshin shqyrtimin e prioritetëve dhe propozimeve për avancimin e procesit të punës, përkatësisht situatën në fushën e punës për të cilën kandidati emërohet.

Kandidati i cili ka realizuar më shumë se 50% të pikëve në testin në formë të shkruar, mund ti qaset intervistës së strukturuar.

Mbi datën, vendin, kohën dhe mënyrën e verifikimit, kandidatët nga lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit publik do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunës së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 20 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

**Komuna e Tuzit**  
**Sekretariati për vetëqeverisje lokale- Zyra për burime njerëzore**  
**Me shënim: për Konkurs publik- në vend pune Menaxher/e i/e komunës së Tuzit**  
Kontakt tel: +38220875167

Përpunoi:  
Valbona Sinishtaj  
Person zyrtar i autorizuar II

